

**VENDIM**  
**Nr.729, datë 29.9.2008**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV  
ABC”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv abc”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge, me zonë licencimi bashkinë e Korçës.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 6.2.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Mesila Doda (Demi)**